

Akt Themelimi

I shoqerise tregtare "Farmaci Sidi" sh.p.k

Mbeshtetur Ligjin nr.9901, date 14.04.2008" Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar, dhe Ligjin 9723 date 3.5.2007 per "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar dhe formalitet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket : individe me persona te kufizuar, krijojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar " Farmaci Sidi shpk " me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur Farmaci Sidi shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare Farmaci Sidi shpk do te kete seline me adrese:Rruga Robert SHVARS,Pallati Piro ,Shkalla 1 ,zona katadastrale 3292,nr pasurie 106/52-N1 ,Selite , Tirane .Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie, dege , te krijojte filial si Brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim asamblese dhe ortakeve te saj.

Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktiviteti e saj ne fushat e :

-Farmaci. Import eksport, Tregtim me shumice e pakice medikamentesh, mallra te sektorit farmaceutik industrial, pajisje mjekesore dhe cdo gje tjeter ne fushen e mjekesise. Import eksport, grumbullim, perpunim, tregtim me shumice e pakice bimesh mjekesore dhe etero-vajore, etj ne kete fushe. - Tregtimin,import-exportin,me shumice dhe me pakice te mallrave industriale,ushqimore, blektorale, bujqesore, veshmbathjeve, materiale ndertimi, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, pllakave ,dyerve , mobiljeve (edhe prodhimin e tyre),artikujve kozmetike,lendeve te perpunuara dhe te

paperpunuara te bimeve medicinale,te lendes drusore,plastikr,duroalumininit,tregtimin mepakic te karburanteve dhe vajrave lubrifikante.Ne fushat e tjeraihapjen e bar-bufeve,restoranteve,parukerive,salon mode,qender estetike,fitnesi,organizim konkursesesh te ndryshme,pikave te servisit lavazhit e mallrave te hotelevejshatrave turistike,moteleve si dhe agjensive turistike,per shitblerje,dhenie me qera te pasurive te tundshme dhe te patundshme,agjensive komisionere, transport te udhetareve dhe mallrave si Brenda dhe jashte.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cdo lloj shkak.

Kapitali I Shoqerise

Neni 5

Kapitali fillestar I shoqerise Farmaci Sidi shpk do te jete 100000 leke (Njeqind mije leke).Kapitali zoterohet 100% nga ortaku u vetem Paola Isufaj I perber nga nje kuote me vlere nominale 100000 leke.Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet(por jo ne vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi I Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administrator i saj.Administratori caktohet Paola Isufaj I cili do te jete perfaqesuesi ligjor I shoqerise.Ajo eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.Cdo kontrate do te kryhet prej saj dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me procure te posacme.Mandati i administratorit do te jete 5 (pese) vjet me te drejte riemerimi.Administratori mund te shkarkohet nga detyra perpara mbarimit te mandatit me vendim te Ortakeve.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te shoqerise.

Neni 8

Ortaket e shoqerise kane te drejte te emerojne dhe administrator te tjere te vlerave material. Kane te drejte te caktoje likuiditete per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesore Tirane.

Neni 10

Shoqeria ka vleren e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e kriuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecenarisht Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Krijimin e Shoqerise Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 3 kopje , per tju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbahet ne dokumentacionin baze te shoqerise Farmaci Sidi shpk.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise.

Ortaket e shoqerise

Tirane, me 13/7/2021

Paola ISUFAJ

Paola Isufaj
IS